



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 895/1 prot.

Tepelenë, më 21.04. 2022

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tepelenë.

KËSHILLTARËVE TË BASHKISË

Sheshi “Lord Bajron”, Tepelenë.

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË Z. TËRMET PEÇI

Sheshi “Lord Bajron”, Tepelenë.

Të nderuar Këshilltarë,

Ju njoftoj se ditën e enjte më datë 28.04.2022, ora 11:00, në Pallatin e Kulturës Tepelenë (kati i dytë) do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Neni 53, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, me rend dite si vijon:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi vendimet e Këshillit Bashkiak të mbledhjes së muajit Mars datë 31.03.2022.
3. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë 31.03.2022.
4. **Projektvendim** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Mars 2022”.
5. **Projektvendim** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Mars 2022”.
6. Prezantimi i raporti të monitorimit të performancës /buxhetit të Bashkisë Tepelenë për vitin 2021.

7. **Projektvendim** “Për dhënie e ndihmë financiare”.
8. **Projektvendim** “Për përfundim procedure privatizimi banese shtetërore”.
9. **Projektvendim** “Për miratimin dhe zbatimin e programit social të strehimit subvencionimi i interesave të kredisë, hartuar sipas udhëzuesit operacional”.
10. **Projektvendim** “Për zhvillimin e pronës nr. 355/4 në Zonën Kadastrale nr. 1565, me zhvillues subjektin “GLE-ALB 2019” shpk me NIPT L99722501A; Zhvillimin e pronës nr. 2/1 dhe 231/1 në Zonën Kadastrale nr. 1480, pronës nr. 766 në Zonën Kadastrale nr. 3452, me zhvillues subjektin Person Fizik “Sidorela Isufi” me NIPT M19820501J, si dhe autorizimin e zhvilluesve apo përfaqësuesve me prokurë noteriale, të aplikojnë për pajisjen e objektit/investimit me lejet përkatëse, në portalin “e-Albania””.
11. **Projektvendim** “Për azhurnimin e segmentit rrugor “Kryqëzimi i varrezave – Shkolla e fshatit” dhe i pasurive nr.: 222/68, 222/72, 227/71, 249, Zona Kadastrale nr. 2680, fshati Mezhgoran”.
12. **Projektvendim** “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë për vitin 2019”, të ndryshuar””.
13. **Projektvendim** “Për miratimin e fillimit të procesit për kalimin në pronësi ose ndryshimin e statusit nga përdorim në pronësi sipas VKM-së nr. 6, datë 06.01.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës” të pasurive nr.: 4/55, 4/79, 4/89, 5/1÷5/14, 9/197,10/53, 10/172, 21/147, 21/1, 21/100, 21/122, 22/50, 22/3, 22/5, 22/40, 22/46, 22/131 dhe 22/132,ndodhur në zonën kadastrale nr. 3574, Njësia Administrative Tepelenë”.
14. **Projektvendim** “Për dhënie titull nderi”.
15. Informacion nga Drejtoria e Zhvillimit Rural, sektori i administrimit të pyjeve dhe kullotave, mbrojtjes së tokës dhe ujërave “Mbi masat e marra në sektorin e bujqësisë, sistemimi dhe investimet në kanalet kulluese e vaditëse, asistenca teknike ndaj fermerëve, arritjet dhe sfidat si dhe problematikat e hasura”.
16. Çështje të tjera.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Elvis Shehu

MBLEDHJET E KOMISIONEVE

Datë 27 Prill 2022

- **Komisioni i Ekonomisë dhe Kryetarët e Komisioneve**, ditën e mërkurë, datë 27.04.2022, ora 12:00, në Pallatin e Kulturës Tepelenë, do të shqyrtojë pikat 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13 të rendit të ditës.
- **Komisioni Arsim – Kulturës dhe dhënies së titujve të nderit**, ditën e mërkurë datë 27.04.2022, ora 12:30, në Pallatin e Kulturës Tepelenë, do të shqyrtojë pikën 14 të rendit të ditës.